REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN
02 Nr. / Br 609/19
Nr. i fq. / Br. st
Data: / Datum 08.05.2019
VUSHTRRI - VUČITRN

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67 “f” dhe “g” të Statutit të Komunës, nenin 5 pika 5 të Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Vushtrrisë si dhe me propozim të Drejtorisë për Shërbime Publike dt. 07.05.2019, Kryetari i Komunës merr këtë:

# V E N D I M
## PËR FORMIM TË KOMISIONIT

1. Formohet komisioni për shqyrtim të ankesave dhe parashtresave të gjeneruesve të mbeturinave në këtë përbërje:

   1.1 Mentor Jashari, kryesues
   1.2 Islam Latifi, anëtar
   1.3 Besarta Muzaqi, anëtare

2. Komisioni në përbërje të cekur në pikën paraprake të këtij vendimi do të shqyrtoj ankesat dhe parashtresat e paraqitura nga palët - gjenerues të mbeturinave në territorin e Komunës së Vushtrrisë si dhe kthej përgjigje palëve në raste të tilla.

3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Xhafer Tahiri

Kryetar i Komunës

Vendimi i dërgohet:
- Drejtorisë për Shërbime Publike
- Anëtarëve të komisionit
- Arkivit të Sekretarisë.

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN
02 Nr. / Br 645/19
Nr. i fq. / Br. st
Data: / Datum 16.05.2019
VUSHTRRI - VUČITRN

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 67, "f" dhe "g" të Statutit të Komunës, si dhe nenin 2, pika 2.2, nënpika 2.2.4 të Marrëveshjes për Bashkëfinancim 02nr. 82/19, datë 31.01.2019 në mes të Shoqatës Bëmirëse "Jetimat e Ballkanit dhe Komunës së Vushtrrisë, Kryetari i Komunës merr këtë:

## VENDIM
## PËR EMËRIM TË ORGANIT MBIKQYRËS

1. Z. **Ahmet Shuku**, ingj. i arkitekturës në Drejtorinë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, emërohet organ mbikëqyrës në projektin "Ndërtimi 25 (njëzetepesë) shtëpive për banim për familje në gjendje të rëndë ekonomike e sociale në territorin e Komunës së Vushtrrisë".

2. I lartpërmenduri, duhet të ndërmerr të gjitha masat dhe aktivitetet e mbikëqyrjes së punimeve me rastin e ndërtimit të shtëpive duke bashkëpunuar ngushtë me kontraktuesin (kryesin e punimeve) si dhe investitorin (Shoqatën "Jetimat e Ballkanit") në mënyrë që të ndërtohen konform standardeve të pranuara mbi ndërtimin.

3. Organi mbikëqyrës në çdo kohë duhet të mbaj të informuar Kryetarin e Komunës përmes raporteve me shkrim për ecurinë e zhvillimit të punimeve sikurse edhe për pengesat eventuale në punë.

4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Xhafer Tahiri

Kryetar i Komunës

Vendimi i dërgohet:
- Drejtorit për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit
- Z. Ahmet Shuku
- Arkivit të Sekretarisë.

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN
02 Nr. / Br 659/19
Nr. i fq. / Br. st
Data: / Datum 20.05.2019
VUSHTRRI - VUČITRN

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

K r y e t a r i

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67 "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

# V E N D I M

1. Lejohet pagesa e mëditjeve për pjesëmarrje në punëtorinë e organizuar nga GIZ-i, mbajtur në Durrës – Shqipëri, nga data 16-18.05.2019, për zyrtarët e komunës si në vijim:

   1.1 Refik Maloku – DSHP
   1.2 Islam Latifi – DSHP
   1.3 Mentor Jashari - DSHP
   1.4 Arben Mlinaku – DSHP
   1.5 Idriz Ismajli – ZK
   1.6 Abit Abiti - DBF

2. Në llogari të z. Mentor Jashari, përveç mëditjeve të paguhet shuma e mjeteve për taksë rrugore, të bashkëngjitur në shtojcë të këtij vendimi.

3. Pagesat të bëhen nga buxhetet e njësive buxhetore përkatëse të zyrtarëve të përfshirë në vendim.

4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Xhafer Tahiri

Kryetar i Komunës

REPUBLIKA E KOSOVËS · KOMUNA E VUSHTRRISË · REPUBLIKA KOSOVO · OPŠTINA VUČITRN · II

Vendimi i dërgohet:
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Arkivit të Sekretarisë.

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN
02 Nr. / Br 660/19
Nr. i fq. / Br. st
Data: / Datum 20.05.2019
VUSHTRRI - VUČITRN

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67 "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

# VENDIM

1. Lejohet pagesa e faturës nr. 0015056 datë 03.05.2019, në shumë prej 57.50 € (pesëdhjetëeshtatëeuro e pesëdhjetë cent) me rastin e shpenzimeve të krijuara në DPH "Prestige" në Vushtrri me zyrtar të Ministrisë së Infrastrukturës.

2. Pagesa e shumës së cekur në pikën paraprake të këtij vendimi të bëhet nga buxheti i Zyrës së Kryetarit të Komunës.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Xhafer Tahiri

Kryetar i Komunës

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E VUSHTRRISË
II
OPŠTINA VUČITRN
REPUBLIKA KOSOVO

Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,
- Arkivit të Sekretarisë.

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN
02 Nr. / Br 661/19
Nr. i fq. / Br. st
Data: / Datum 20.05.2019
VUSHTRRI - VUČITRN

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

K r y e t a r i

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67 "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

# V E N D I M

1. Lejohet pagesa e faturës nr. 0015060 datë 10.05.2019, në shumë prej 414.00 € (katërqindekatërmbëdhjetë euro) me rastin e shpenzimeve të krijuara në DPH "Prestige" në Vushtrri me delegacion i biznesmenëve nga Sllovenia.

2. Pagesa e shumës së cekur në pikën paraprake të këtij vendimi të bëhet nga buxheti i Zyrës së Kryetarit të Komunës.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Xhafer Tahiri

Kryetar i Komunës

Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Arkivit të Sekretarisë.

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN
03 Nr./Br 682/19
Nr. i Fq./Br. st -02-
Data:/Datum 24.05.2019
VUSHTRRI - VUČITRN

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA VUSHTRRI

Bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 11 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme Nr.03/L-139 me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205, dt. 28 tetor 2010, dhe nenin 67 "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës, me datën 24.05.2019, merr këtë:

## VENDIM PËRFUNDIMTAR

1. Miratohet shpronësimi për interes publik, realizimin e projektit për ndërtimin e urës mbi lumin "Silnicë" në fshatin Pestovë, Komuna e Vushtrrisë, të pronës të paluajtshme si në vijim:

   - P-70202051-00829-0, në sipërfaqe prej 457 m2, nga sipërfaqja e përgjithshme prej 457 m2, ZK-Pestovë, pronar në pjesë ideale 1/1 Jahir Halim Mehmeti nga Pestova, Komuna Vushtrri.
   - P-70202051-00830-0, në sipërfaqe prej 187 m2, nga sipërfaqja e përgjithshme prej 320 m2, ZK-Pestovë, pronar në pjesë ideale 1/1 Rexhep Adem Mehmeti nga Pestova, Komuna Vushtrri.
   - P-70202051-K01254-0, në sipërfaqe prej 160 m2, nga sipërfaqja e përgjithshme prej 7123 m2, ZK-Pestovë, pronar në pjesë ideale 1/1 Rifat Namon Namoni nga Pestova, Komuna Vushtrri.

2. Për pronën e shpronësuar, do të paguhet kompensimi në emër dhe llogari të pronarëve të cekur në nenin 1 të këtij Vendimi, apo zotëruesit të interesit, në bazë të akt vlerësimeve të Ministrisë së Financave – Departamentit të Tatimit në pronë dt.06.12.2018.

3. Akt vlerësimi është pjesë përbërëse e këtij vendimi dhe i është bashkangjitur në shtojcë.

4. Brenda 2 (dy) viteve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi do të paguhet në tërësi shuma e kompensimit për pronën e shpronësuar me këtë vendim.

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN
02 Nr. / Br 693/19
Nr. i fq. / Br. st
Data: / Datum 28.05.2019
VUSHTRRI - VUČITRN

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67 "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

# VENDIM

1. Lejohet pagesa e faturës nr. 0015066 datë 23.05.2019, në shumë prej 575.00 € (pesqindeshtatëdhjetëepesë euro) me rastin e shpenzimeve të krijuara në DPH "Prestige" në Vushtrri – iftar me stafin e Bashkësisë Islame në Vushtrri.

2. Pagesa e shumës së cekur në pikën paraprake të këtij vendimi të bëhet nga buxheti i Zyrës së Kryetarit të Komunës.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

REPUBLIKA E KOSOVË
KOMUNA E VUSHTRRISË
OPŠTINA VUČITRN
REPUBLIKA KOSOVA

Xhafer Tahiri

Kryetar i Komunës

Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Arkivit të Sekretarisë.

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN
02 Nr. / Br 694/19
Nr. i fq. / Br. st
Data: / Datum 28.05.2019
VUSHTRRI - VUČITRN

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67 "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

# V E N D I M

1. Lejohet pagesa e faturës nr. 810129157 datë 25.05.2019, në shumë prej 915.00 € (nëntëqindepesëmbëdhjetë euro) me rastin e shpenzimeve të krijuara në Amazona Hotel SH.P.K. në Milloshevë, Obiliq me përfaqësues të Shoqatës së Bizneseve nga Diaspora.

2. Pagesa e shumës së cekur në pikën paraprake të këtij vendimi të bëhet nga buxheti i Zyrës së Kryetarit të Komunës.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E VUSHTRRISË
OPŠTINA VUČITRN
REPUBLIKA KOSOVO

Xhafer Tahiri

Kryetar i Komunës

Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Arkivit të Sekretarisë.

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN
02 Nr. / Br 708/19
Nr. i Sq. / Br. st
Data: / Datum 30.05.2019
VUSHTRRI - VUČITRN

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008) dhe nenit 67 "g" të Statutit të Komunës, si dhe kërkesën dt. 22.05.2019 të Menaxherit të Shoqatës "Handikos" në Vushtrri, Kryetari i Komunës merr:

# VENDIM

1. Nga buxheti i komunës, njësia buxhetore – Drejtoria për Shërbime Publike, kategoria mallra dhe shërbime, lejohet furnizimi me karburante të automjetit zyrtar të Shoqatës "Handikos" në Vushtrri, në sasi prej 70 l. (shtatëdhjetë litra) brenda një muaji.

2. Furnizimi sipas pikës paraprake te këtij vendimi të bëhet në pikën e karburantit "Fer Petrol" në Vushtrri.

3. Obligohet Menaxheri i Shoqatës "Handikos" që në fund të çdo muaji të dërgoj faturat e furnizimit me karburante te shefi i autoparkut të komunës.

4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Shërbime Publike, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Menaxheri i Shoqatës "Handikos", Shefi i autoparkut të komunës

5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit dhe do të vlej deri më 31.12.2019

Xhafer Tahiri

Kryetar i Komunës

Vendimi i dërgohet:
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,
- Drejtoria për Shërbime Publike,
- Menaxheri i Shoqatës "Handikos",
- Shefi i autoparkut të komunës,
- Arkivit të Sekretarisë

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN
02 Nr. / br 709/19
Nr. Fq. / Br. st
Data: / Datum 30.05.2019
VUSHTRRI - VUČITRN

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008) dhe nenin 67 “g” të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës jep këtë:

# U R DHË R E S Ë

1. Urdhëroj të gjithë të punësuarit në Administratën e Komunës që të respektojnë me përpikëri orarin e punës, duke vënë kartelën identifikuese për hyrje dalje në aparatin e vendosur në hyrje të ndërtesës së komunës.

2. Të punësuarit në Administratën e |Komunës gjithashtu obligohen që ta përdorin kartelën për hyrje dalje, përveç në mëngjes në ora 8;00 dhe dalje në ora 16;00 edhe me rastin e hyrje daljeve në kohën e pauzës si dhe çdo rast tjetër të hyrje daljeve brenda orarit të punës.

3. Për daljet brenda orarit të rregullt të punës, duhet siguruar paraprakisht leja nga drejtori i drejtorisë përkatësisht mbikëqyrës i drejtpërdrejtë.

4. Për mosrespektim të kësaj urdhërese do të merren masa disiplinore konform legjislacionit të zbatueshëm.

5. Mbikëqyrjen e zbatimit të kësaj urdhërese do ta bëjnë drejtorët e drejtorive apo mbikëqyrësit e drejtpërdrejtë në bashkëpunim me udhëheqësin e personelit.

6. Udhëheqësi i personelit obligohet që këtë urdhëresë do ta vendosë në ambientet e dukshme në ndërtesën e komunës dhe objektet e administratës jashtë ndërtesës së komunës.

7. Urdhëresa hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit dhe do të zbatohet nga data 05.06.2019.

Xhafer Tahiri

Kryetar i Komunës

Urdhëresa i dërgohet:

- Drejtorëve të Drejtorive
- Udhëheqësit të Personelit
- Arkivit të Sekretarisë